



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr.350/02-17823/26 dt.02/02/2026 (sipas e-Leja KKN-00833), në emër të aplikuesve Blerim dhe Alush Sejdiu dhe investitorit Axis Investment SH.P.K e përfaqësuar nga Naim Avdyli, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit shumëbanesor me afarizëm, me etazhitet B+2S+P+6, në kuadër të bllokut urban “C2/ZB” të Planit Rregullues të Hollësishëm “Kalabria” 2024-2032, në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.01876-5, nr.01876-11 dhe nr.01876-21 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 05.03.2026 deri më 19.03.2026, në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumë-banesore me afarizëm
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues/Rruga publike/Rruga e planifikuar
c. Vija ndërtimore	Sipas Planit Rregullues Të Hollësishëm “Kalabria 2024-2032 “
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	1.0 H/Distanca nga ndërtesa
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	0.5H m’ 0.25H/m’
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=40 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 %, e kërkuar,
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=2.4, Koeficienti 2.4
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=80 %
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	/
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
n. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:


